

DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS

19.08.2024

DALJE - IZLAZ - PASSING

No/№:

01/685/2024

Drejtori Qendror - Optia Lirava - Central Administration



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*



*Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs*

---

# PLANI STRATEGJIK

## 2024-2028

## PËRMBAJTJA

1. Përmbledhja ekzekutive.....	
2. Hyrje.....	
3. Qëllimi dhe Vizioni i Strategjisë.....	
4. Metodologjia.....	
5. Parimet e përgjithshme.....	
6. Sfondi.....	
7. Objektivat e Strategjisë.....	
7.1 Objektivi Strategjik 1. Mbledhja e të hyrave për buxhetin e Kosovës .....	
7.2 Objektivi Strategjik 2. Lehtësimi i tregtisë, thjeshtëzimi dhe harmonizimi i procedurave doganore.....	
7.3 Objektivi Strategjik 3. Mbrojtja e shoqërisë, lufta efikase ndaj evazionit fiskal, krimin të organizuar, kontrabandës dhe aktiviteteve tjera të paligjshme.....	
7.4 Objektivi strategjik 4. Modernizimi, avancimi i kapaciteteve dhe ngritja e performancës.....	
8 Zbatimi, monitorimi dhe raportimi i Strategjisë.....	
9 Ndikimi buxhetor i zbatimit të Strategjisë.....	
10 Shtojcat .....	
Shtojca A - Plani i Veprimit të Strategjisë 2023-2024.....	
Shtojca B - Plani i Monitorimit.....	
Shtojca C - Plani i Performancës.....	

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dogana e Kosovës (në tekstin e mëtejme DK) duke marrë parasysh rolin dhe misionin e saj ka hartuar Planin Strategjik të Doganës së Kosovës, si dokument gjithëpërfshirës i politikave doganore, i cili përmban qëllimin, vizionin, vlerat dhe objektivat strategjike për periudhën pesë vjeçare 2024-2028.

Institucionet e Republikës së Kosovës, bëjnë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e situatës në qëndrueshmërinë fiskale, në fushën e sundimit të ligjit dhe në mënyrë efikase merren me luftimin e kontrabandës dhe ekonomisë joformale, kushte këto të cilat i paraprijnë progresit drejt integritimit evropianë, duke zbatuar një politikë të besueshme dhe reale. Dogana e Kosovës si autoritet në kuader të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme MFPT) zbaton politika doganore të orientuar drejt një qasje pro-aktive dhe transparente ndaj të gjitha palëve të interesit.

Objektivat Strategjike të Doganës së Kosovës, të përfshira në këtë dokument, janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të MFPT dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me përkrahjen e tyre mundësojnë funksionimin e një administrate moderne doganore, avancimin e një sistemi efikas të mbledhjes së të hyrave, lehtësimin e tregtisë legjitime dhe fuqizimin e kapaciteteve për mbrojtjen e shoqërisë.

Strategjia e DK-së, është dokumenti i cili prezanton situatën e përgjithshme, funksionalitetin institucional, sfidat e tanishme, parimet themelore që ndërlidhen me udhëheqjen dinamike drejt modernizimit dhe qasjes pro-aktive për të siguruar qëndrueshmërinë e mbledhjes së të hyrave, për të lehtësuar tregtinë e ligjshme, për të mbrojtur shoqërinë dhe për të mirëmbajtur dhe avancuar tutje kapacitetet për një zhvillim afatgjatë.

Kjo strategji është vazhdimësi e strategjive paraprake dhe mbështetet në legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën doganore. Përderisa, strategjitë paraprake kanë pasur si qëllim kryesor themelimin dhe zhvillimin e mekanizmave institucional, kjo strategji ka për qëllim avancimin e mëtejme të mekanizmave dhe proceseve të DK-së. Gjithashtu Dogana e Kosovës përmes strategjisë së saj ka për qëllim avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar si dhe të ndihmojë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale në luftimin e çdo dukurie negative që dëmton interesat e qytetarëve dhe vendit.

Përmes këtij Plani Strategjik 2024-2028 si dhe Planit të Veprimit si pjesë integrale e saj, synohet të përcaktohet qartë rruga e Doganës Kosovës në arritjen e objektivave të përcaktuara sa i përket mbledhjes së të hyrave, luftimit të kontrabandës dhe ekonomisë joformale, luftimit të korrupsionit brenda organizatës, ngritjes së standardeve të shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe publikun e gjerë, performancës operationale, infrastrukturës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

## 2. HYRJE

Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë në fushën e mbledhjes së të hyrave dhe mbrojtjen e shoqërisë. DK përveç kontributit për çështje ekonomike, kontribut të çmuar jep edhe në çështjen e sigurisë së vendit, duke luftuar dhe parandaluar aktivitetet ilegale, kontrabandimin e narkotikëve, armëve, municionit dhe substancave tjera eksplozive, përfshirë edhe mallrat me përdorim të dyfishtë dhe mallrat që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Duke marrë në konsideratë rezultatet konkrete të arritura deri tani, DK vlerësohet si një nga institucionet me vlera të larta organizative dhe ndër kontribuuesit kryesor në buxhetin e shtetit në aspektin e mbledhjes së të hyrave si dhe mbrojtjes së qytetarëve të saj. Të hyrat e mbledhura nga Dogana e Kosovës përbëjnë rreth 50% të të hyrave të gjithmbarshme që grumbullohen për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Duke marrë në konsideratë se planifikimet e të hyrave për vitet e ardhshme pritet të kalojnë vlerat mbi 1.75 miliard euro, Qeveria e Kosovës vazhdon të ketë pritje të mëdha nga Dogana e Kosovës edhe për një periudhë afatmesme. Në anën tjetër politikat fiskale si dhe ato që burojnë nga marrëveshja e Stabilizim Asociimit, MTL-ve, favorizojnë ulje taksash në kategori të caktuara, si stimulim i zhvillimit ekonomik, prodhimit dhe përpunimit dhe pritet që vitet në vijim ky ndikim të jetë edhe më i theksuar.

Konform rolit dhe strategjive nacionale, pritet nga DK do të jenë të orientuara edhe në krijimin e kushteve të favorshme për ambientin e të bërit biznes në Kosovë. Ndërsa në fushën e sigurisë dhe luftën kundër krimit të organizuar trans-kufitar dhe terrorizmit, luftimin e ekonomisë jo-formale do të ketë përkushtim të lartë institucional me qëllim të luftimit dhe parandalimit të dukurive negative si dhe avancimit të bashkëpunimit rajonal dhe me gjerë.

Bazuar në vlerësimet e raportit të BE-së dhe vlerësimeve nga raportet tjera, ekonomia joformale llogaritet të jetë rreth 30%. Kjo shifër i atribuohet kryesisht evazionit në fushën e tatimeve të brendshme, kontrabandës përmes vijës së gjelbër kufitare dhe nën-deklarimeve të vlerave në import.

Dokumenti strategjik 2024-2028 është një udhërrëfyes i rëndësishëm përmes të cilit synohet ngritja e nivelit të performancës së doganes me qëllim që kjo të ndikoj në zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve profesionale doganore, të cilat sigurojnë se do të kontribuojnë arritjes së qëllimeve të përbashkëta në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit, lehtësirave tregtare dhe doganore, luftimin dhe parandalimin e çdo dukurie negative që dëmton interesat e vendit, por njëkohësisht edhe orientimin e resurseve të nevojshme për të arritur objektivat e parapara përmes këtij dokumenti.

Gjithashtu përmes këtij dokumenti synohet të pasqyrohen qartë ambicien e Doganës së Kosovës për të avancuar më tutje organizatën drejt një administrate moderne dhe të

qëndrueshme, duke pasur parasysh sfidat që mund të paraqiten në të ardhmen, me qëllim të përshtatjes së proceseve të punës dhe reagimit adekuat karshi situatave, në shërbim të qytetareve, bizneseve dhe mbrojtjes së interesave të vendit tonë dhe me gjerë, prandaj edhe funksioni i DK-së bazohet në parime demokratike të drejtësisë, llogaridhënies, transparencës, barazisë dhe profesionalizmit, parakushte këto që e përbëjnë një organizatë moderne dhe në shërbim të drejtë dhe të pa anshëm për qytetarin dhe bizneset.

Planit Strategjik 2024-2028 gjithashtu përfaqëson raportin midis vlerësimit të aftësisë për të kryer aktivitetet siç është planifikuar përmes përfundimit të planeve të veprimit, dhe një vlerësimi cilësor të aplikuar për veprime të tjera që fokusohen në ndikimet e aktiviteteve të Doganës së Kosovës.

### 3. QËLLIMI DHE VIZIONI I STRATEGJISË

**QËLLIMI** – Ky dokument përcakton prioritetet dhe objektivat strategjike si dhe veprimet të cilat Dogana e Kosovës synon t'i ndjekë për periudhën 2024-2028. Përmes kësaj strategjie, synohet përdorimi sa më racional i burimeve në dispozicion, zbatimi i politikave dhe zhvillimi i procedurave që lidhen me zinxhirin e tregtisë ndërkombëtare, qarkullimin e lirë të mjeteve dhe udhëtarëve, si dhe kontrollin doganor në kufi dhe në brendi.

**VIZIONI** – Dogana e Kosovës do të vazhdojë me qasje pro-aktive në avancimin e kapaciteteve, duke operuar si agjenci e integruar dhe e orientuar në rezultate e cila bazohet në sisteme të ndërtuara, inteligjencë dhe menaxhim adekuat të rrezikut.

### 4. METODOLOGJIA

Strategjia e Doganës së Kosovës është hartuar në mbështetje të objektivave dhe dokumenteve strategjike të MFPT dhe Qeverisë së Republikës Kosovës. Ky dokument është në harmoni edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

Hartimit të kësaj strategjie i kanë parapri vlerësimet dhe analizat e strategjive të mëhershme, OBD-së, raporteve analitike dhe vlerësuese për Doganën e Kosovës, dhe dokumenteve tjera relevante, si :

- Programi i Qeverisë 2021-2025;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030;
- Programi për Reforma në Ekonomi 2022-2024;
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së;
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2025.

Për më tepër, Plani Strategjik ndjek edhe standardet e Organizatës Botërore të Doganave, Udhërrëfyesit të Komisionit Evropian për Doganat (Customs Blueprint), si dhe nismat regjionale dhe ndërkombëtare që përkrahin zhvillimin dhe modernizimin e administratave doganore.

Kjo strategji, synon realizimin optimal të objektivave strategjike përmes zërthimit në objektiva specifike dhe ndërmarrjes së aktiviteteve të nevojshme në të gjitha nivelet e Doganës së Kosovës. Për të mbështetur zbatimin e kësaj strategjie është hartuar Plani i Veprimit dhe monitorimit (Aneksi A) i cili është pjesë integrale e Planit Strategjik dhe përcakton aktivitetet dhe treguesit konkret, sfidat dhe rreziqet si dhe njësitë përgjegjëse organizative dhe afatet e përbushjes.

## 5. PARIMET DHE VLERAT E PËRGJITHSHME

Konform rolit dhe përgjegjësive të përcaktuara, Dogana e Kosovës si një ndër institucionet e para të themeluara në Kosovë në vitin 1999, dhe institucion shumë i rëndësishëm i Republikës së Kosovës udhëhiqet nga parimet e drejta të kushtetutshmërisë, meritokracisë, llogaridhënies, transparencës, barazisë dhe profesionalizmit. Dogana e Kosovës gëzon pavarësi operationale dhe është e përkushtuar që të ofroj shërbime cilësore për komunitetin e biznesit dhe publikun.

Gjatë zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe procedurave të aplikueshme, Dogana e Kosovës bazohet në standarde të larta të sjelljes, bazuar në parimet themelore si:

- Shërbimi cilësor, ndershmëria dhe besimi;
- Motivimi dhe zhvillimi i potencialit njerëzor;
- Puna në ekip dhe fryma bashkëpunuese;
- Llogaridhënia;

Zyrtarët e Doganës së Kosovës në punën e tyre të përditshme janë përgjegjës për zbatimin e këtyre vlerave dhe me sjelljen e tyre ndikojnë drejtpërsëdrejti në imazhin e saj. Zbatimi i këtyre parimeve dhe vlerave është një faktor kyç në aspektin e funksionimit efikas të organizatës.

### Vlerat e Doganës

Kultura organizative e Doganës së Kosovës reflekton vlerat fundamentale të paanshmërisë, përkushtimin për ofrimin e shërbimeve, integritetit, llogaridhënies, respektit dhe etikës.

Vlerat e Doganës bazohen në (PIT):

- P - Profesionalizëm
- I - Integritet dhe
- T - Transparencë

## 6. SFONDI

Dogana e Kosovës si autoritet ekzekutiv në kuadër të MFPT zbaton politikën doganore në tërë territorin unik doganor të Republikës së Kosovës dhe një pjesë të kontrollit e shtrin edhe në Republikën e Shqipërisë në suaza të një marrëveshjeje bilaterale, duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e ligjit, ruajtjen dhe forcimin e sigurisë publike, shëndetin publik dhe lehtësirat doganore, kompetenca këto të cilat janë duke u fuqizuar në vazhdimësi me strategji qeveritare dhe bazë ligjore përkatëse.

Ligji nr. 03/L-050 Për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në nenin 3 ka përcaktuar se Drejtori i Doganave është anëtarë i përhershëm i këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe prezenca e Doganës së Kosovës në kufi dhe me aktivitetet në brendi të vendit luan rol të rëndësishëm duke kontribuar në sigurinë e përgjithshme. Për më tepër, duke qenë një prej akterëve kryesor në kontrollin e zinxhirit furnizues, dogana me kapacitetet e saja ndërmerr veprime operative dhe hetimore për të bartur përgjegjësi në fushën e sigurisë kufitare me qëllim që ti kontribuoj përpjekjeve të përbashkëta ndaj kërcënimeve të sigurisë kombëtare, rajonale dhe më gjerë.

Trendet bashkëkohore globale të tregtisë ndërkombëtare kanë shënuar rritje të madhe dhe të shpejtë dhe se ky trend pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Me rritjen e qarkullimit ndërkufitar të mallrave, njerëzve dhe automjeteve është shtuar dukshëm edhe trysnia mbi autoritetet kufitare për të siguruar në njërin anë lëvizje të shpejtë të mallrave dhe njerëzve dhe në anën tjetër adresimin dhe trajtimin e rreziqeve komplekse në rritje.

Me liberalizimin e lëvizjes së tregtisë botërore dhe sfidat aktuale të sigurisë nga krimi i organizuar ndërkufitar, terrorizmi dhe format tjera të dukurive negative, janë shtuar pritjet në vazhdimësi nga qeveria, komuniteti i biznesit dhe publiku për rolin e doganave në parandalimin e këtyre dukurive që cenojnë interesat financiare, shëndetin dhe sigurinë. Dogana me prezencën e saj në kufi permanent ballafaqohet me problematikat më komplekse të tregtisë ndërkombëtare, sikurse edhe me trajtimin e mallrave të kufizuara dhe ato të ndaluara.

Në mënyrë që Dogana të siguroj shërbime efikase ndaj komunitetit të tregtisë në njërin anë si dhe të jetë në gjendje të adresoj rreziqet e shtuara që i bashkëngjiten këtyre trendëve, duhet të siguroj avancim adekuat të sistemeve doganore, që të jenë në harmoni me këto zhvillime në mënyrë që në kërkim të adresimit të rreziqeve të mos bëhet pengesë e tregtisë e cila është një prej funksioneve fundamentale të zhvillimit ekonomik të vendit. Në veçanti do të vazhdohet me thjeshtëzimin e procedurave doganore dhe lehtësirave tregtare që ndikojnë në rritjen ekonomike dhe nxitjen e eksportit vendor.

Projeksioni Qeveritar për mbledhjen e të hyrave pritet të jete ambicioz edhe për vitet në vijim, respektivisht të jetë i nivelit progresiv me rreth mbi 50% në një periudhë afatmesme. Në të njëjtën kohë, politikat e fundit fiskale si dhe ato që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim

Asociimit, dhe Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë- MTL me vendet tjera, në vazhdimësi favorizojnë ulje taksash në kategori të caktuara, si stimulim i zhvillimit ekonomik. Në këtë sfond, Dogana e Kosovës është e përkushtuar të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve në implementim të kësaj strategjie.

Për shkak të pranisë së tyre në kufi, Dogana është e thirrur të zbatojë shumë pjesë të legjislacionit jo-doganor të ndërlidhura me strategjitë shtetërore siç janë: strategjia për parandalimin e mallrave me përdorimin të dyfishtë, armët e zjarrit, pronësinë intelektuale, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorit, etj.

## **7. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Objektivat Strategjike të Doganës së Kosovës janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të MFPT si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilave synohet modernizimi i mëtejshëm i administratës doganore, sistemi efikas i mbledhjes së të hyrave, lehtësimi i tregtisë legjitime, mbrojtja e shoqërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve.

Në përputhje me qëllimin dhe vizionin, ky dokument përcakton katër objektiva strategjike, të cilat pasqyrojnë përgjegjësitë dhe obligimet ndaj objektivave strategjike shtetërore, dhe pritshmërinë e komunitetit të biznesit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

### **Objektivat strategjike:**

- 1: Mbledhja e të hyrave për buxhetin e Kosovës,**
- 2: Lehtësimi i tregtisë, thjeshtëzimi dhe harmonizimi i procedurave doganore,**
- 3: Mbrojtja e shoqërisë, lufta efikase ndaj evazionit fiskal, krimit të organizuar, kontrabandës dhe aktiviteteve tjera të paligjshme,**
- 4: Modernizimi, avancimi i kapaciteteve dhe ngritja e performancës**

### **7.1 MBLEDHJA E TË HYRAVE PËR BUXHETIN E KOSOVËS**

Dogana e Kosovës në planin strategjik ka për objektiva që të krijojë një sistem të sigurt, efikas dhe modern për mbledhjen e të hyrave përmes inkurajimit të përmbushjes vullnetare të detyrimeve doganore.

Në mënyrë që të lehtësohet qasja e bizneseve në shërbime, Dogana do të punojë në modernizimin e infrastrukturës doganore, avancimin e sistemeve automatike të proceseve të punës të nivelit bashkëkohor dhe në linjë me praktikën më të mirë të vendeve të BE-së, që

aplikojnë procese dhe procedura më të avancuara. Dogana e Kosovës është e përkushtuar të forcoj partneritetin me komunitetin e biznesit dhe ti mbështesë taksapaguesit me qëllim që ata t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore në mënyrë sa më të lehtë dhe efikase.

Në anën tjetër, Dogana e Kosovës do të vazhdoj me avancimin e kapaciteteve dhe sistemit të menaxhimit të rrezikut duke shfrytëzuar metodat e avancuara në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve që mund të cenojnë interesat financiare të Kosovës. Kjo do të rrisë efektivitetin në punën e Doganës dhe do të ulë nivelin e rrezikut të shmangies së pagesës së taksave.

DK do të vazhdojë tutje partneritetin e ngushtë me komunitetin dhe përfaqësuesit e biznesit duke ndarë vizionin tonë të përbashkët me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të procedurave doganore. DK do të avancoi sistemet ekzistuese për mbikëqyrjen e mallrave akcizore, regjistrimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e prodhuesve të mallrave akcizore, tregtarëve, monitorimin e lëvizjeve ndërkufitare të mallrave me akcizë.

Në fokus do të jetë nxitja për një bashkëpunim më të madh në mes administratave doganore fqinje dhe vendeve tjera partnere në realizimin e objektivave dhe politikave të përbashkëta. Në veçanti do të vazhdohet në avancimin e harmonizimit të procedurave doganore me vendet fqinje, duke zgjeruar fushat e përbashkëta të bashkëpunimit, siç janë unifikimi dhe thjeshtëzimi i proceseve të punës. Harmonizimi dhe zbatimi i rregullave të përbashkëta doganore tek transiti i mallrave ndërmjet vendeve të regjionit dhe BE-së në një mjedis dinamik paraqet sfidë të veçantë në vazhdimësi.

Dogana e Kosovës do të vazhdoj të investoj në avansimin e teknologjisë informative në mënyrë që sistemet dhe shkëmbimi i të dhënave me vendet e Evropës dhe vendet fqinje të jenë të ndërlidhura.

Realizimi dhe implementimi i objektivit strategjik të mbledhjes së të hyrave do të mundësohet përmes objektivave specifike të përshkruara më poshtë dhe aktiviteteve konkrete të zërthyer në planin e veprimt.

- **Objektivi specifik 1.1.** Avancimi i kapaciteteve operative në mbledhjen e të hyrave.
- **Objektivi specifik 1.2.** Rritja e efektivitetit në procedurat doganore përmes teknologjisë dhe automatizimit.
- **Objektivi specifik 1.3.** Zbatimi i drejtë i politikave fiskale, klasifikimit të mallrave, rregullave të origjinës dhe vlerësimit të mallrave.
- **Objektivi specifik 1.4.** Zhvillimi i sistemit aktual të mbledhjes të akcizës.

- **Objektivi specifik 1.5.** Inkurajimi i mëtejshëm dhe edukimi i komunitetit të biznesit për përmbushje vullnetare.

## 7.2. LEHTËSIMI I TREGTISË, THJESHTËZIMI DHE HARMONIZIMI I PROCEDURAVE DOGANORE

Me qëllim të zvogëlimit të kostos për treg-tinë ndërkombëtare, Dogana e Kosovës synon arritjen e baraspeshës ndërmjet kontrollit doganor dhe lehtësirave tregtare, duke shfrytëzuar aplikimin e drejtë të masave të politikave tregtare dhe doganore, proceseve të avancuara të punës, procedurave të avancuara doganore dhe teknikat për vlerësimin e rrezikut dhe kontrolle të përzgjedhura (selektive).

Dogana e Kosovës do të orientohet drejt zhvillimit të konceptit të një “Dritare e Vetme” (Single Window) me agjencitë tjera dhe do të zbatojë programin e reformave ekonomike, strategjisë për lehtësimin e tregtisë si dhe të promovoj programin e Operatorit të Autorizuar Ekonomik (OAE) për të lehtësuar lëvizjen e tregtisë së ligjshme duke ju përmbajtur parimeve bazë të kornizës SAFE të OBD-së. Lehtësirat tregtare, thjeshtëzimi i proceseve të punës në procedurat doganore dhe thjeshtëzimi i procedurave doganore në kufi sidomos në eksport, do të jenë në funksion të rritjes ekonomike duke mbështetur bizneset legjitime në nxitjen e eksportit vendor në mënyrë që të mund të jenë konkurrues në tregjet regionale dhe më gjerë.

Dogana e Kosovës gjithashtu do të jetë pjesë e iniciativave të lehtësimit të procedurave dhe kontrolleve në kufi sipas modelit “Një ndalje një kontroll”. Kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në lehtësimin e qarkullimit të lirë të mallrave dhe personave, njëherit do ta shkurtoj kohën e pritjes në kufi. Kjo synohet të realizohet përmes punës së përbashkët të autoriteteve kufitare në objekte të përbashkëta edhe me autoritetet kufitare të vendeve që kufizohen me njëra tjetrën.

Përveç lehtësirave dhe shërbimeve të avancuara Dogana e Kosovës do të synoj implementimin dhe zbatimin e proceseve të punës që përfshijnë bashkëpunimin regional dhe më gjerë duke avancuar dhe harmonizuar sistemet të cilat do të mundësojnë shkëmbim të informatave në kohë reale.

Thjeshtëzimi dhe harmonizimi i procedurave të punës do të mundësoj uljen e kostos për tregtarët dhe administrimin më efikas të resurseve në dispozicion.

Dogana e Kosovës do të vazhdojë të menaxhojë dhe të udhëheqë me sistemet ekzistuese, në veçanti atyre që ndërlidhin të gjitha autoritetet doganore përmes avancimit të sistemeve në shkëmbimin e të dhënave dhe me agjencionet e tjera shtetërore, gjithashtu në nivel rajonal dhe më gjerë në implementimin e sistemeve të avancuara.

Aktivitetet e Doganës së Kosovës përgjatë periudhës 2024-2028, do të sigurojnë avancimin tutje të ambientit pa letër (paperless) përmes konceptit të menaxhimit të përmbajtjes (Enterprise Content Management) që kontribuon në lehtësimin e tregtisë dhe zbatimin efektiv të rregullave dhe mbrojtjen e interesave financiare dhe të sigurisë së Kosovës.

Programi i Doganës në veçanti do të mbështesë zhvillimin e sistemeve, proceseve të punës dhe procedurave për:

- Thjeshtëzime specifike të procedurave ekzistuese për të zvogluar kostot e të bërit biznes,
- Thjeshtëzime të proceseve dhe reduktimin e barrës administrative për tregtarët, duke përfshirë thjeshtëzimin e formaliteteve të importit dhe eksportit dhe vendosjen e marrëdhënieve të bazuara në besim,
- Shfrytëzimin e potencialit të plotë të të dhënave dhe krijimi i një qasje më të bashkuar ndërmjet nivelit kombëtar të autoriteteve doganore dhe jo doganore,
- Përkrahje për tregtinë legjitime dhe eliminimin e formaliteteve në drejtim të lehtësimit të tregtisë,
- Bashkëpunimin me komunitetin e biznesit, agjencionet dhe administratat doganore si dhe autoritetet tjera kufitare,
- Orientimin në strategjinë zhvillimore në konceptin e një "Dritare të Vetme" (Single Window).

Dogana e Kosovës, do të vazhdojë të sigurojë aplikimin e drejtë të masave të politikave fiskale dhe tregtare, përditësimin e TARIK-ut si dhe aplikimin e drejtë të rregullave të origjinës.

Realizimi dhe implementimi i objektivit strategjik të lehtësimit të tregtisë, thjeshtëzimit dhe harmonizimit të procedurave doganore, do të mundësohet përmes objektivave specifike të përshkruara më poshtë dhe aktiviteteve konkrete të zërthyer në planin e veprimit.

- **Objektivi specifik 2.1.** Avancimi i proceseve të punës për promovimin dhe lehtësimin e tregtisë.
- **Objektivi specifik 2.2.** Rritja e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit dhe agjencitë e tjera për zbatim të strategjisë kombëtare për lehtësimin e tregtisë.
- **Objektivi specifik 2.3.** Promovimi dhe aplikimi i lehtësirave për eksportuesit, prodhuesit dhe përpunuesit.
- **Objektivi specifik 2.4.** Zvogëlimi i kohës së nevojshme për zhdoganimin e mallrave.

### **7.3. MBROJTJA E SHOQËRISË, LUFTA EFIKASE NDAJ EVAZIONIT FISKAL, KRIMIT TË ORGANIZUAR, KONTRABANDËS DHE AKTIVITETEVE TJERA TË PALIGJSHME**

Roli i Doganave çdo ditë e më tepër është duke u përforcuar edhe në fushën e mbrojtjes së shoqërisë përmes parandalimit të tregtisë së mallrave të ndaluara dhe me një përkushtim më të sforcuar kundër kontrabandës, krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera të paligjshme që

mund të rrezikojnë interesat financiare dhe të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe më gjerë.

Mbledhja, analizimi, trajtimi dhe përdorimi i duhur i informacionit janë elementet kyçe për një luftë të suksesshme kundër krimit ndërkufitar, kontrabandës dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që kërcënojnë tregtinë e ligjshme dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Bashkëpunimi me autoritetet kufitare, përfshirë edhe shtetet fqinje do të rris mundësinë e luftimit me të suksesshëm të krimit dhe kontrabandës. Me qëllim të luftimit të keqpërdorimeve, Dogana e Kosovës synon të vazhdojë edhe më tutje me zhvillimin e sistemit informativ të analizës së rrezikut dhe përzgjedhjes i cili do të mundësojë rritjen e efektivitetit në zbulimin e veprave penale.

Dogana e Kosovës do të vazhdojë ta luftojë ekonominë joformale përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet e tjera qeveritare të zbatimit të ligjit. Me Policinë e Kosovës do të vazhdojë të bashkëpunojë në luftimin e kontrabandës së mallrave përmes kufijve dhe veprimeve tjera ilegale në brendi të territorit, ndërkohë me Administratën Tatimore të Kosovës do të punojë nga afër për të identifikuar bizneset që nuk i përmbushin obligimet tatimore. Gjithashtu si agjenci integrale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit –MIK synojmë intensifikimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë e përfshira në MIK me qëllim të luftimit dhe parandalimit të krimit dhe kontrabandës përmes vijës gjelbër / kaltër të kufirit.

Vlerësimi i rrezikut dhe profilizimi i dërgesave, automjeteve në Pikë Kalime Kufitare (PKK) apo lëvizjes së personave në PKK dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës do të zhvillohen me tutje duke shfrytëzuar kapacitetet e sistemeve të teknologjisë informative dhe shkëmbimit të të dhënave në nivelin vendor dhe ndërkombëtar, siç janë Informacioni Paraprak i Udhëtarëve - IPU dhe Regjistri i Emrave të Udhëtarëve - REU. Zhvillimi i konceptit modern doganor "Operativa e Udhëhequr nga Inteligjenca", do të ndihmojë punonjësit operativ në fokusimin e dërgesave me risk të lartë dhe në hetimin e kontrabandës dhe krimit të organizuar.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me prokurorinë publike do të avancohet me qëllim të hetimit profesional të veprave penale doganore. Dogana e Kosovës do të rrisë kapacitetet operative në fushën e hetimeve financiare dhe identifikimin dhe sekuestrimin e aseteve kriminale.

Sikundër qasjes së Organizatës Botërore të Doganave-OBD, Dogana e Kosovës synon që ti kushtoj rëndësi kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë, mallrave strategjike ku bëjnë pjesë armët e shkatërrimit në masë, përmes avancimit të praktikave të aplikuara në këtë fushë. Siç përcaktohet me kërkesat dhe standardet ligjore të konformitetit, e që janë në linjë me praktikat e BE-së, duke vepruar në koordinim me Inspektoratin e Tregut, ne do të vijojmë me avancimin e sistemit për të siguruar kontrolle efikase mbi Sigurinë e Produkteve.

Në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, DK do të avancojë partneritetin me institucionet qeveritare dhe komunitetin e biznesit për të parandaluar importin e mallrave

të falsifikuara, veçanërisht ato që mund të dëmtojnë shëndetin, sigurinë publike dhe të hyrat. Në këtë plan po ashtu do të adresohen obligimet që dalin nga strategjitë nacionale dhe planet e veprimit, e që ndërlidhen me zbatimin e tyre nga Dogana e Kosovës.

Realizimi dhe implementimi i këtij objektivi strategjik në mbrojtjen e shoqërisë, evazionit dhe aktiviteteve tjera të paligjshme, do të mundësohet përmes objektivave specifike dhe aktiviteteve konkrete të përshkruara me poshtë dhe të zërthyer në planin e veprimit.

- **Objektivi specifik 3.1.** Aplikimi i qasjes pro-aktive për të parandaluar, hetuar dhe zbuluar veprimet e ndryshme ilegale në kufi dhe në brendi të vendit.
- **Objektivi specifik 3.2.** Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin në zbulimin e rasteve, parandalimin e tyre, dhe përmirësimin e besimit të ndërsjellë.
- **Objektivi specifik 3.3.** Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve operative që shërbejnë në mbrojtje të interesave financiare dhe të sigurisë së Kosovës.
- **Objektivi specifik 3.4.** Mbarëvajtja dhe përmirësimi i praktikave në mbrojtjen e shëndetit, përmes zbatimit të kontroleve mbi sigurinë e produkteve.
- **Objektivi specifik 3.5.** Administrimi i mirëfilltë i kontrollit të mallrave strategjike për të parandaluar përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

#### **7.4 MODERNIZIMI, AVANCIMI I KAPACITETEVE DHE NGRITJA E PERFORMANCËS**

Modernizimi i Doganës së Kosovës do të arrihet me ndryshmet në legjislacionin doganor aktual dhe përafrimin me legjislacionin e Kodit të Ri për Doganat në vendet e BE-së, kërkesave sipas standardeve të Organizatës Botërore të Doganave dhe Udhërrëfyesit doganor të BE (EU Blueprint) duke vazhduar tutje ngritjen e kapaciteteve institucionale në fushën e doganave përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e programit të asistencës teknike TAIEX.

Personeli i Doganës është burimi më i vlefshëm dhe më i rëndësishëm për përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të Doganës së Kosovës. Një personel i motivuar, profesional, kompetent, efikas dhe me integritet, do të jetë një kontribuues i rëndësishëm në arritjen e objektivave strategjike. DK do të synoj që të punësoj staf të ri në arritjen e zgjerimit të nevojave dhe kërkesave të kohës në numrin e kërkuar dhe planifikuar prej 621 staf.

Në të njëjtën kohë, Dogana e Kosovës do të zhvillojë edhe më tutje kapacitetet njerëzore, duke përmirësuar ekspertizën e tyre përmes investimit në edukimin e vazhdueshëm të stafit

në fushat e ekspertizës, duke përfituar edhe nga asistenca teknike e Komisionit Evropian dhe donatorëve tjerë.

Gjithashtu pajisjet dhe sistemet përbëjnë vlerë të madhe për personelin e Doganës së Kosovës, ku gjatë kësaj periudhe do të synojmë që përmes donatorëve dhe partnerëve tonë, apo mundësive të brendshme buxhetore që të sigurojmë pajisje moderne/profesionale me qëllim të identifikimit dhe zbulimit të mallrave të ndaluara.

Dogana e Kosovës synon zhvillimin e një sistemi efikas të menaxhimit të burimeve njerëzore për të avancuar sistemet, matjen e performancës, si dhe zhvillimin profesional. Dogana e Kosovës do të intensifikojë pjesëmarrjet në aktivitetet e Organizatës Botërore të Doganave dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe atyre rajonale, me qëllim të adoptimit të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar prioritet do të jetë zbatimi efikas i masave dhe veprimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asocim (MSA), Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian dhe arritja e marrëveshjeve të reja, si dhe anëtarësimi në konventat ndërkombëtare. Dogana e Kosovës do të promovojë pjesëmarrjen aktive në prezantimin e projekteve dhe programeve të ndryshme të BE-së dhe donatorëve, të cilët do të përkrahin proceset integruese.

Kodi i Ri Doganor dhe i Akcizave synon përafrimin e legjislacionit Doganor të Kosovës me atë të BE-së, si dhe krijimi i një klime legjislative të përshtatshme për operatorët ekonomikë që veprojnë në tregun ndërkombëtar duke synuar, qartësimin, lehtësimin dhe thjeshtimin e procedurave doganore dhe luftën kundër mashtrimit, për t'ju përgjigjur zhvillimeve të tregtisë ndërkombëtare si dhe nevojave të operatorëve ekonomikë.

Me Kodin e Ri Doganor sigurohet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për rregullat dhe procedurat doganore, duke përshtatur zhvillimet e fundit në fushën e tregtisë dhe mjetet moderne të komunikimit, duke siguruar sistem plotësisht të automatizuar çka mundëson që operatorët ekonomikë të përfitojnë plotësisht nga teknologjia e informacionit.

Dogana e Kosovës do të përkushtohet në ndërmarrjen e veprimeve të reformave që burojnë nga procesi i gjithmbarshëm i integriteteve evropiane të Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor në raport me publikun është ruajtja e reputacionit të organizatës, transparenca dhe fuqizimi i besimit ndaj Doganës së Kosovës. Duke u nisur nga fakti se ne paguhemi nga taksapaguesit andaj edhe pritjet e tyre janë që zyrtarët doganorë t'i kryejnë detyrat e tyre me profesionalizëm, integritet, në mënyrë të paanshme dhe të drejtë.

Dogana e Kosovës, do të vazhdoj të përmirësoj masat antikorrupsion, me synim të implementimit të objektivave, qëllimit dhe vizionit të përcaktuar me këtë Plan Strategjik. Gjithashtu do të vazhdohet me forcimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me autoritetet tjera të zbatimit të ligjit, për të rritur efektivitetin në zbulimin e rasteve, parandalimin e konfliktit të kompetencave, dhe përmirësimin e besimit të ndërsjellë.

Realizimi dhe implementimi i këtij objektivit strategjik të modernizimit, avancimit dhe ngritja e performances të fuqizimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të administratës doganore do të mundësohet përmes objektivave specifike të përshkruara me poshtë dhe të zbërthyer në planin e veprimit.

- **Objektivi specifik 4.1.** Modernizimi dhe digjitalizimi i proceseve dhe procedurave të punës.
- **Objektivi specifik 4.2.** Zhvillimi dhe ndërtimi i një politike të qëndrueshme të burimeve njerëzore.
- **Objektivi specifik 4.3.** Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve infrastrukturore, kushteve teknike të punës, menaxhimit të projekteve.
- **Objektivi specifik 4.4.** Përafrimi i legjislacionit doganor primar dhe sekondar me legjislacionin e BE-se dhe nxjerrja e udhëzuesve për zbatimin e legjislacionit doganor.
- **Objektivi specifik 4.5.** Promovimi i integritetit, etikes, qeverisjes së mirë dhe luftimit të korrupsionit.
- **Objektivi specifik 4.6.** Rritja e transparencës dhe informimi i publikut për profesionalizmin, besueshmërinë dhe imazhin e Doganës.
- **Objektivi specifik 4.7.** Përforcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në fushën e doganave.

## **8. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË**

Dogana do të siguroj zbatimin e strategjisë përmes përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve do të jenë pjesë përbërëse e procesit të strategjisë si dhe element kryesor në përmbushjen e saj.

Zyra për Planifikim Strategjik në baza të rregullta do të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit duke përditësuar raportet tre mujore dhe vjetore nga të gjitha njësite organizative dhe do të hartoj raportet e planit të veprimit, monitorimit të zbatimit të strategjisë.

Procesi i vlerësimit do të rezultojë në rishikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit duke siguruar planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave strategjike dhe planit të performancës.

Zbatimi i objektivave strategjike do të vlerësohet bazuar në treguesit kryesor të performances, projeksionit dhe mbledhjes së të hyrave, ndërtimin e klimës së të bërit biznes dhe lehtësirave tregtare, uljen e evazionit fiskal dhe modernizimit të administratës.

Treguesit kryesor të performances do të zërthehen tutje në kuadër të Planit të Veprimit për secilin aktivitet.

## 9. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Dogana e Kosovës do të sigurohet se burimet financiare për zbatimin e kësaj Strategjie janë përdorur në përputhje me parimet e menaxhimit të financave publike dhe procedurat e vendosura të kontrollit. Ndikimi buxhetor i kësaj strategjie i referohet KASH 2024-2025 dhe përkrahjes nga fondet dhe projektet e financuara ngas Komisioni Evropian dhe donatorët tjerë.

## 10. SHTOJCA A- PLANI I VEPRIMIT STRATEGJIK 2024-2026

Strategjia e Doganës zbatohet përmes Planit të Veprimit 2024-2026, i cili përmban aktivitetet e detajuara dhe do të rishikohet në baza vjetore.

*Shtojcat :*

- Shtojca A – Plani i Veprimit Strategjik për vitin 2024-2026
- Shtojca B – Plani i Monitorimit
- Shtojca C – Plani i Performancës

Aprovuar

Datë: 06.03.2024

Agron Llugaliu

Drejtor i Përgjithshëm  
Dogana e Kosovës

